



| | | | |
|----------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Pritiljeno/Prodato Received/Delivered | 17.12.2021 | 1 viti god. year | |
| Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHICK | 6214/2021 | | 113 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.979/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj- Demi kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.437/2020 të datës 22.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.07/2020 të datës 07.01.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr.“Bajram Pllana”, Nr.126, Prishtinë, kundër organit të punësimit-Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.12.2021 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.07/2020 të datës 08.01.2020, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 08.01.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër shkresës zyrtare me numër protokollit 10093 të datës 16.09.2019 të Udhëheqëses së Divizionit të Personelit në MIT, me pretendimet ankimore se sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, i punësuar me rastin e pensionit ka të drejtën e kompensimit të tri (3) pagave jubilarë, në vlerën e pagës së fundit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.01.2020 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, ndërsa Këshilli me datë 07.02.2020, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.02.2020 përmes shkresës me numër protokollit 288/2020, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.07/2020 të datës 08.01.2020, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë gjyqësore në gjykatën kompetent gjegjësisht Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 16.11.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.437/2020, me të cilin ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të datës 06.02.2020, duke e obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 08.01.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të Protokollit 23/2020 të datës 08.01.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjën në kërkesë të datës 16.09.2019 me numër të protokollit 04-10093; Emalin e datës 04.12.2013; Listën e Personelit të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin e datës 01.11.2017 me numër protokollit 01-8531 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit; Kërkesën e datës 06.09.2019 me numër të protokollit 05-9764 drejtuar Sekretarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Autorizimin e datës 06.09.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.01.2020 me numër të protokollit 51/2020; Përgjigjën në ankesë të datës 07.02.2020 me numër të protokollit 308/2020; Vendimin e datës 08.11.2017 me numër të protokollit 01-8531; Dëshminë për pagimin e pagave shtesë për ankuesin; Njoftimin e datës 06.02.2020 me numër të protokollit 288/2020; Certifikatën e Vdekjes se datës 19.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit *sepse:*

Sipas vlerësimit të shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Certifikatës së Vdekjes me Nr. V 10378608 të datës 01.02.2021, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka ndërruar jetë me datë 01.02.2021, andaj, bazuar në këtë rrethanë dhe në kuptim të dispozitave të nenit 102 paragraf 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar: *"Nëse një person fizik vdes gjatë procedurës administrative të nisur për një çështje kryekëput personale (intuitu personae), organi publik do të mbyllë dosjen dhe do përfundojë procedurën administrative"*, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi që të përfundojë procedurën administrative të iniciuar me ankesën e të ndjerit me numër A.nr.07/2020 të datës 08.01.2020.

Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente/Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.979/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj -Demi

Kryetare e Kolegji



Vendimi i dërgohet''

- Në adresën e te ndjerit si në dispozitiv të vendimit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit;
- Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative;
- Arkivit të KPMSHCK.

